



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Tiranë, më 02.12.2011

6340/
Prot.
4

URDHËR

Nr. 579, datë 02.12.2011

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR "FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROVIMIT
TË SHTETIT, PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË "**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 10 të ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për "Funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit, për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë."
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Komisionet e Provimit të Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 349/ot.

2

Tiranë, më 2.12.2011
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

MIRATOHET

MYQEREM TAFAJ
MINISTER


RREGULLORE

PËR

“FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROVIMIT TË SHETIT, PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”

Kjo rregullore nxirret në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

1. Komisioni i Provimit të Shtetit (KPSH) rregullon veprimtarinë e tij mbështetur në këtë rregullore, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe që përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisioni i Provimit të Shtetit, që më pas në tekst do të quhet Komisioni, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij.
2. Veprimtaria e Komisionit ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, me Rregulloren për "Organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", si dhe me rregullore, e cila ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik për veprimtarinë e tij.

Neni 2
Funksioni i Kryetarit të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit mbledh Komisionin dhe drejton diskutimet, koordinon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
2. Kryetari, në rast mungese të tij, delegon kompetencat e tij nënkryetarit të Komisionit.

Neni 3
Funksioni dhe detyrat e Komisionit

1. Komisioni i Provimit të Shtetit ka këto detyra:
 - a. Shqyrton e miraton programin e provimit të shtetit;
 - b. Shqyrton dhe miraton fondin e pyetjeve për provimin e shtetit, për profesionin e rregulluar dhe raportin e disiplinave në fondin e pyetjeve;
 - c. Përcakton formatin e përmbajtjes së testit;
 - d. Shqyrton ankimimet e kandidatëve, në rastet e kërkuara nga Agjencia Kombëtare e Provimeve;
 - e. Firmos procesverbalin e rezultateve;
 - f. Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Provimeve për mbarëvajtjen e provimit të shtetit.
2. Komisioni i Provimit të Shtetit, në funksionimin e tij, ndjek procedurat e mëposhtme:
 - a. Komisioni merr në dorëzim nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) fondin e pyetjeve të Provimeve të Shtetit.
 - b. Komisioni shqyrton fondin e pyetjeve për ndërtimin e tyre në bazë të standardeve të përcaktuara nga AKP dhe bën grupimin e tyre, si më poshtë:
 - i. në pjesë/module sipas nënspecialiteteve;
 - ii. nivele vështirësie: Niveli I- V)1: i lehtë, Niveli II- V)2: mesatar dhe Niveli III- V)3: i vështirë;
 - c. Komisioni shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:
 - i. peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes. Kur komisioni vëren se nuk përmbushen këto kushte, atëherë ai ndryshon formulimin e pyetjes duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve, ose e heq atë;
 - ii. përcaktimin e vështirësisë së pyetjeve duke bërë ndryshime në se e sheh të arsyeshme;
 - iii. numrin e alternativave (deri në pesë alternativa).
 - d. Komisioni përcakton formatin e testit të provimit, duke konsideruar:
 - i. % e përfshirjes së pyetjeve sipas nivelit të vështirësisë;
 - ii. % e përfaqësimit të çdo pjese/moduli në tezë;
 - iii. uniformitetin e përfaqësimit të nënspecialiteteve në përputhje me programet e studimeve të ndjekura në IAL publike dhe jo publike;

- iv. përfshirjen në programin e shpallur të pyetjeve të paraqitura nga grupet e hartimit.
- e. Komisioni dorëzon brenda 7 ditëve kalendarike, fondin e përpunuar të pyetjeve në AKP, ku paraqiten në mënyrë të dallueshme ndryshimet e kryera prej tij.
- f. Komisioni siguron prezencën me së paku një anëtar të autorizuar, pranë AKP-së në ditën e zhvillimit të provimit.
- g. Kryetari i Komisionit ose nënkryetari apo çdo anëtar tjetër i autorizuar prej kryetarit asiston në prodhimin elektronik të tezës së provimit të shtetit dhe kryen kontrollin e saj, para se ajo t'iu paraqitet kandidatëve në ekranin e kompjuterit.
- h. Komisioni, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të AKP-së, firmos në kohën e përcaktuar dëshminë e përfundimit të provimeve të shtetit, për çdo kandidat që kalon provimin.

Neni 4

Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Komisionit

1. Me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit dhe të autoritetit kompetent përkatës ngrihet Komisioni i Provimit të Shtetit, me këtë përbërje:
 - a. një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon fushën e arsimit;
 - b. një përfaqësues i autoritetit kompetent;
 - c. një përfaqësues, anëtar i UP-së përkatëse;
 - ç. dy përfaqësues nga personeli akademik i universiteteve, të akredituara për programin përkatës të studimit të profesionit të rregulluar, të cilët kanë titullin shkencor "Profesor" dhe kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë.
2. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 2 të këtij neni emërohen sipas mënyrës së mëposhtme:
 - a. UP-ja i propozon autoritetit kompetent të paktën dy kandidatura, prej të cilave zgjidhet përfaqësuesi i përcaktuar në shkronjën "c" të pikës 2 të këtij neni;
 - b. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës i propozon ministrit që mbulon fushën e arsimit, të paktën, katër kandidatura, prej të cilave përzgjidhen dy përfaqësuesit e përcaktuar në shkronjën "ç" të pikës 2 të këtij neni.
3. Në rast se përfaqësimi i UP-së në Komisionin e Provimit të Shtetit nuk është i mundur, autoriteti kompetent përfaqësohet me një anëtar shtesë.
4. Kryetari i Komisionit të Provimit të Shtetit është përfaqësuesi i përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni.

Neni 5

Mbledhjet e Komisionit

1. Komisioni mbledhet mbi bazën e një kalendari semestral, në varësi të datave të zhvillimit të provimit të shtetit.

2. Komisioni mblidhet me kërkesë të Kryetarit të Komisionit ose Agjencisë Kombëtare të Provimeve.
3. Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit.

Neni 6 **Marrja e vendimeve**

1. Komisioni merr vendime me shumicën të thjeshtë të anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të vepruar, nuk mund të abstenojnë.
2. Anëtarët e Komisionit, përpara marrjes së vendimeve, deklarojnë nëse janë në kushtet e konfliktit të interesit. Asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje që lidhen me të personalisht apo familjarë e të afërm të tij, në përputhje me Ligjin Nr. 9367, datë 07. 04. 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
3. Marrja e vendimeve bëhet në mënyrë të hapur.

Neni 7 **Procesverbali i rezultateve**

1. Për rezultatet e provimeve të shtetit për çdo profesion të rregulluar mbahet procesverbali i rezultateve.
2. Procesverbali i rezultateve firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit të Shtetit.
3. Procesverbali i rezultateve mbahet dhe redaktohet nga AKP-ja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 348/3
Prot.

Tiranë, më 06.12.2011

Lënda: Shkresë përcjellëse

Drejtuar: Z. Alfons Harizaj
Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Provimeve

TIRANË

I nderuar Z. Drejtor,

Lutemi po ju përcjellim bashkëlidhur Urdhrin Nr. 579, datë 02. 12. 2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për miratimin e rregullores për “Funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit, për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

SKËNDER UKU

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

